



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-077

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN LIGJIT Nr. 2003/7 PËR LËNDËN ARKIVORE
DHE ARKIVAT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullativës ligjore përkitazi me veprimtarinë, aktivitetet dhe funksionimin institucional për Lëndën Arkivore dhe Arkivat,

Miraton

**LIGJ PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN LIGJIT Nr. 2003/7 PËR LËNDËN
ARKIVORE DHE ARKIVAT**

Neni 1

Neni 2 të Ligjit për Lëndën arkivore dhe arkivat i vihet ky titull:
“Agjencia Shtetërore e Arkivave”

Paragrafi 2.1 i këtij neni ndryshohet si vijon:

2.1 Me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive të përcaktuara me këtë ligj Drejtoria e Arkivave shndërrohet në Agjenci Shtetërore të Arkivave si institucion qendror në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës – Zyrës së Kryeministrit, i cili organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Neni 2

Neni 2 shtohet paragraf i ri paragrafi 2.2 si vijon:

2.2 Agjencia Shtetërore e Arkivave” e Kosovës është person juridik, ka vulën me stemën e Republikës së Kosovës dhe emërtimin e vet. Aktivitetet e Agjencisë do të udhëhiqen nga Kryeshefi i Agjencisë, i cili i raporton dhe i përgjigjet Kryeministrit.

Paragrafi 2.2 i Ligjit bëhet paragrafi 2.3 e kështu me radhë.

Neni 3

Kudo që në ligj përdoren fjalët: “Drejtoria e arkivave zëvendësohen me fjalët “Agjencia Shtetërore e Arkivave”

Neni 4

Neni 20 paragrafit 20.2 ndryshohet si vijon:

20.2. Institucionet arkivore të Kosovës janë:

- 20.2.1. Agjencia Shtetërore e Arkivave;
- 20.2.2. Arkivi Shtetëror i Kosovës;
- 20.2.3. Arkivat Ndërkomunale;
- 20.2.4. Arkivat Komunale;
- 20.2.5. Arkivat Speciale;
- 20.2.6. Arkivat Private.

Neni 5

Kudo që në ligj përdoren fjalët: “Drejtori i Arkivit të Kosovës” zëvendësohen me fjalët: “Kryeshefi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave”

Neni 6

Neni 24 i ligjit plotësohet dhe ndryshohet si ne vijim:

Paragrafi 24.1 i ligjit fshihet.

Paragrafi 24.2 i Ligjit bëhet paragrafi 24.1 e kështu me radhë.

Neni 7

Neni 44 i Ligjit plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

Paragrafi 44.3 i Ligjit, rreshti i dytë pas presjes “mund të japë urdhër apo udhëzim administrativ” ndryshohet dhe bëhet “mund të japë urdhër apo udhëzim profesional”

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-077
7 nëntor 2008**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI